


ZYRA PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIMIT TË PARTIVE NË REBUBLIKËN E KOSOVËS DHE ATË TË ÇEKISË

MAJ 2020, PRISHTINË/PRAGË



ZYRA PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIMIT TË PARTIVE NË REBUBLIKËN E KOSOVËS DHE ATË TË ÇEKISË

COPYRIGHT © 2020. KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate apo materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga i ka marrë ato citate ose materiale që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Autor: **Florent Spahija (KDI TIK) dhe Jan Dupák (TICZ)**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në kuadër të Programit për Promovimin e Tranzicionit të implementuar në bashkëpunim me Transparency International Czech Republic (www.transparency.cz). Opinione, gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi ekskluzive e KDI-së dhe e TICZ-së, ndaj nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Shkurtesat	6
Hyrje	7
Rregullimi ligjor i mbikëqyrjes së financave të subjekteve politike në Kosovë	8
Funksionimi i ZRPPC në kuadër të KQZ-së dhe përbërja e saj	9
Drejtori Ekzekutiv i Zyrës	10
Regjistrimi, certifikimi dhe mbikëqyrja financiare e subjekteve politike nga Zyra..	11
Regjistrimi	11
Certifikimi	11
Mbikëqyrja financiare e shpenzimeve të fushatës	12
Problemet në mbikëqyrjen financiare nga Zyra	14
Republika Çeke dhe rregullimi ligjor i mbikëqyrjes së financave të subjekteve politike	16
Pozita e Zyrës brenda kornizës së administratës publike dhe përbërja e saj	17
Mbikëqyrja e financimit të partive politike nga ana e Zyrës	19
Mbikëqyrja mbi fushatat zgjedhore nga ana e zyrës	20
Kompetencat e tjera të Zyrës	22
Funksionimi aktual i Zyrës deri më sot	23
Problemet e zbuluara në strukturën e ÚDHPSH-së	24
Problemet e zbuluara në operimin e ÚDHPSH-së	25



Shkurtesat

KDI Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë

LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë

TICZ – Transparency International Republika Çeke

ÚDHPSH” apo “Zyra” - Zyra për mbikëqyrjen e financimit të partive dhe lëvizjeve politike në Çeki

ZRPPC-ja apo Zyra - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në Kosovë



Hyrje

Kjo analizë është prodhim i përbashkët i Institutit Demokratik të Kosovës (Transparency International Kosova) dhe Transparency International nga Republika e Çekisë, në kuadër të realizimit të projektit të përbashkët për rritjen e transparencës në financimin e subjekteve politike.

Objekt i analizës është shtjellimi i bazës ligjore dhe praktikave, si dhe institucioneve kompetente për kontrollin dhe mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike në të dy vendet, të cilat janë në stadi të ndryshme të nivelit të demokracisë.

Republika e Kosovës i ushtron këto kompetenca përmes një Zyre të veçantë në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila ka mandat regjistrimin e subjekteve politike, certifikimin e tyre dhe mbikëqyrjen e financave. Një zyrë të veçantë dhe të pavarur për mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike dhe lëvizjeve politike e ka Republika Çeke.

Dallimi esencial në mes të dy shteteve qëndron në pavarësinë e zyrave në ushtrimin e roleve mbikëqyrëse si dhe në deklaratimet financiare të subjekteve politike. Ndryshimet mund të shihen edhe në strukturën e zyrave, hierarkinë institucionale, kompetencat e tyre, fuqinë ligjore si dhe aspekte të tjera të mbikëqyrjes së subjekteve politike nga këto zyra. Kjo analizë ka bërë të mundur edhe nxjerrjen në pah të mangësive që këto zyra kanë në funksionimin e tyre të përditshëm.



Rregullimi ligjor i mbikëqyrjes së financave të subjekteve politike në Kosovë



Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në Kosovë, është e themeluar nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i vitit 2008, Ligji Nr. 03/L-073. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar.

Pas shpalljes së pavarësisë, në kuadër të konsolidimit të legjislacionit themelor, Kosova ka miratuar edhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, me të cilin ndër tjerash është rregulluar mbajtja e zgjedhjeve në Kosovë, funksionalizimi dhe kompetencat e KQZ-së, kompetencat e Sekretariatit të KQZ-së, kompetencat e ZRPPC-së, kodi i mirësjelljes për

subjektet politike gjatë zgjedhjeve, mënyra e kontrollimit të financave të subjekteve politike si dhe kërkesat ligjore për raportim.

Deri në vitin 2008, në Kosovë kompetencat për regjistrimin e subjekteve politike i kishte Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) përmes shtyllës së tretë të qeverisjes. Përgjegjëse për shtyllën e III është ishte OS-BE-ja (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë), në kuadër të të cilës ka funksionuar Zyra për Regjistrimin e Partive Politike¹, të cilat më pas kanë garuar në zgjedhjet që janë mbajtur para shpalljes së pavarësisë. Nga viti 2006, e deri në miratimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme më 2008, kjo Zyrë gradualisht ka bartur kompetencat e saj tek institucionet e Kosovës, përkatësisht tek KQZ-ja.

Nga viti 2006, e deri në miratimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme më 2008, kjo Zyrë gradualisht ka bartur kompetencat e saj tek institucionet e Kosovës, përkatësisht tek KQZ-ja.



¹ Urdhëresa Administrative të UNMIK-ut nr. 2004/01, Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/16 e ndryshuar, për regjistrimin dhe veprimtarinë e partive politike në Kosovë.



Funksionimi i ZRPPC-së në kuadër të KQZ-së dhe përbërja

Në pajtueshmëri me ligjin, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka themeluar Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC). Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit të Partive Politike; certifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre për zgjedhje; kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuara politike gjatë fushatave; si dhe Deklarimeve Financiare.

ZRPPC-ja funksionon në kuadër të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sekretariati i KQZ-së është trupa kryesore teknike administrative që zbaton vendimet që merren KQZ-ja, përgatitë raportet, rekomandimet dhe vendimet për KQZ-në, asiston KQZ-në në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi të cilat janë caktuar me ligj apo me akte të tjera.² Udhëheqës i Sekretariatit është Kryeshefi ekzekutiv, i cili është shërbyes civil dhe i përgjigjet vetëm KQZ-së.³ Regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e tyre, Sekretariati e ushtron përmes Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim.

Në aspektin administrativ, ZRPPC-ja është e vendosur nën Sekretariatit e KQZ-së, por për punët dhe përgjegjësitë e saj ligjore i përgjigjet drejtpërdrejt KQZ-së.⁴ Zyra udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv, i cili po ashtu i raporton drejtpërdrejt KQZ-së.⁵ Ky rregullim ligjor ka paraparë një pavarësi të Zyrës ndaj Sekretariatit të KQZ-së, përkundër faktit që në hierarkinë administrative qëndron nën Sekretariat.⁶ Po

ashtu Sekretariatit i është mohuar në mënyrë shprehëmore raportimi për punët e Zyrës përkatësisht të drejtorit të Zyrës⁷ në KQZ.

Sipas përshkrimit ligjor dhe kompetencave që i parasheh Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, pozita e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është mjaft e rëndësishme për shkak të kompetencave që ka dhe hierarkisë institucionale brenda KQZ-së.

Sidoqoftë, Zyra nuk e ka një buxhet të ndarë për funksionimin e saj, ndaj numri i stafit mbështetës permanent të është dy zyrtar dhe drejtori. Gjatë periudhës së zgjedhjeve numri i zyrtarëve mund të shkojë deri në 30 zyrtar të përkohshëm.

Zyra krijon dhe mban kuti postare për secilin subjekt politik të certifikuar nga KQZ-ja. E gjithë korrespondenca zyrtare në të shkruar me subjektet politike bëhet përmes Personit Kontaktues⁸ dhe kutisë postare. Subjektet janë të obliguara që rregullisht t'i kontrollojnë kutitë postare që gjenden në KQZ.⁹

² Neni 65 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

³ Neni 66 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është themeluar në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës së Kosovës, dhe është një organ i përhershëm i pavarur. KQZ, është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Kosovë. Roli i KQZ-së është të rregullojë procesin elektoral përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore dhe, mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standardet ndërkombëtare. KQZ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: nga Kryesuesi dhe dhjetë (10) anëtarë të tjerë. Kryesuesi, emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe zgjidhet mes gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Mandati i Kryetarit të KQZ-së është (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës. Dhjetë (10) anëtarë të tjerë të KQZ-së, emërohen si rezultat i nominimeve të gjashtë (6) grupeve parlamentare më të mëdha të Kuvendit të Kosovës dhe, katër (4) anëtarë që përfaqësojnë komunitetet e vogla në Kosovë.

⁵ Neni 11.2 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

⁶ Po aty

⁷ Neni 66.5 pika b, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

⁸ Person kontaktues është personi i cili është i autorizuar të komunikojë në emër të subjektit politik me zyrën për çështje jo-financiare

⁹ Neni 11.5 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>



Drejtori Ekzekutiv i Zyrës

Drejtori ekzekutiv i Zyrës është një zyrtar i lartë brenda Sekretariatit të KQZ-së me një pozitë udhëheqëse, ai ka disa detyra dhe përgjegjësi në kuadër të punës së tij të përditshme.¹⁰ Kontrata e tij është kontratë e karrierës dhe e pa afat.

Fillimisht përgjegjësia kryesore që ka është administrimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i zyrës duke nënkuptuar edhe menaxhimin e stafit të zyrës. Tutje drejtori ekzekutiv siguron që funksionet e zyrës të zbatohen në përputhje me akte ligjore, nënligjore në fuqi dhe vendimet e KQZ-së. Drejtori i Zyrës përgatit raporte dhe ia rekomandon KQZ-së drejtpërdrejt, pastaj koordinon aktivitetet me Sekretariatit e KQZ-së dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

Drejtori i Zyrës në kuadër të kompetencave të tij e ka edhe hartimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me Zyrën, akte të cilat edhe mund t'i delegoj tek stafi vartës por çdo herë nën mbikëqyrjen e tij. I njëjti është i ngarkuar edhe me planifikim në lidhje me aktivitetet që do t'i realizojë Zyra gjatë punës së përditshme apo sipas kërkesave apo koordinimet që rrjedhin nga bashkëpunimi me KQZ-në, Sekretariatit apo PZAP-në. KQZ-ja mund ta ngarkoj drejtorin e Zyrës me detyra dhe përgjegjësi të tjera që bijnë në funksionin e tij si drejtor apo detyra dhe angazhime të tjera për kryerjen sa më të mirë të punëve që dalin gjatë punës.

Një funksion të veçantë që ka drejtori ekzekutiv është këshillimi i subjekteve politike lidhur me obligimet ligjore që kanë ndaj KQZ-së. Pos këshillimit, drejtori mund t'i udhëzojë subjektet politike se si të veprojnë në obligimet që dalin nga ligji. Kjo kompetencë është ndihmesë e madhe për subjektet politike, pasi që çdoherë mund t'i drejtohen Zyrës apo drejtorit për këshilla e udhëzime se si të veprohet në realizimin e kërkesave që dalin nga Ligji apo KQZ-ja.

Drejtori i Zyrës përfaqëson Zyrën brenda dhe jashtë institucionit, respektivisht në takimet e KQZ-së, në raportimin para saj, si dhe në raport me Sekretariatit. Ndërkaq nga aspekti i jashtëm, drejtori e përfaqëson Zyrën në takime me subjektet politike në radhë të parë, me PZAP-në, apo subjekte të tjera (përfshi OJQ-të e Mediat) ku Zyra është e ftuar për t'u përfaqësuar. Normalisht kompetencat e përfaqësimit kufizohen vetëm në detyrat dhe përgjegjësitë ligjore, të cilat i ka Zyra.



Drejtori ekzekutiv i Zyrës është një zyrtar i lartë brenda Sekretariatit të KQZ-së me një pozitë udhëheqëse, ai ka disa detyra dhe përgjegjësi në kuadër të punës së tij të përditshme. Kontrata e tij është kontratë e karrierës dhe e pa afat.

¹⁰ Neni 11.2 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>





Regjistrimi, certifikimi dhe mbikëqyrja financiare e subjekteve politike nga Zyra

Tri funksionet kryesore që lidhen me subjektet politike brenda KQZ-së kryhen nga Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim.¹¹ Funksioni i parë është regjistrimi i subjekteve politike në regjistrin e Partive Politike. Funksioni i dytë është certifikimi i subjekteve politike për pjesëmarrje në zgjedhje (zgjedhje të përgjithshme apo komunale). Ndërkaq funksioni i tretë dhe i fundit është mbikëqyrja financiare e subjekteve politike në raport me të hyrat, shpenzimet dhe deklarimet e subjekteve politike brenda afateve ligjore.

Regjistrimi

Aplikimi për regjistrimin e partive politike mund të bëhet në çdo kohë brenda orarit të rregullt të punës. Aplikimi duhet të dorëzohet në Zyrën për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim.¹² Aplikimi duhet të bëhet në bazë të rregullave të vendosura nga KQZ-ja dhe sipas formatit të parapërcaktuar.

Zyra duhet t`i shqyrtoj aplikimet brenda 10 ditësh nga dita e pranimit të aplikimit dhe 5 ditë pas përfundimit të rishikimit, kërkesave për ndryshim apo sqarimeve shtesë nga aplikuesi. Më pas Zyra ka 30 ditë kohë nga pranimi i aplikimit, që ta njoftoj KQZ-në me statusin e aplikimit duke i rekomanduar edhe veprimin e mëtejshëm. KQZ-ja nga Zyra mund ta marrë rekomandimin pozitiv për pranimin e aplikimit-regjistrimin, apo ta negativ për mos regjistrim. Zyra ka edhe një mundësi

që t`i rekomandojë KQZ-së të kërkojë saktësime shtesë në fshat të cilat nuk janë të sqaruara siç duhet.¹³

Secila parti politike obligohet që një herë në vit në Zyrë ta dorëzojë formularin për vazhdimin e regjistrimit. Afati vjetor për dorëzim është data 31 mars i çdo viti.¹⁴ Partia politike duhet që për çdo ndryshim që e bën në strukturat e saj ta njoftoj Zyrën në afat prej 5 ditësh pas ndryshimeve.

Certifikimi

Nënkupton certifikimin e subjekteve politike për të marrë pjesë në zgjedhjet të cilat janë shpallur dhe do të mbahen nga KQZ-ja.¹⁵ Aplikimet për certifikim mund të dorëzohen në çdo kohë gjatë orarit të rregullt të punës së Zyrës. Afati për dorëzimin e aplikimit për certifikim është 60 (gjashtëdhjetë) ditë para ditës së zgjedhjeve. Pas kalimit të afatit, Zyra ligjërisht nuk mund të pranojë asnjë aplikim për certifikim.¹⁶ Këto afate ndryshohen, përkatësisht shkurtohen nga KQZ-ja në rastet e zgjedhjeve të parakohshme, ku përmes planit operacional vendosen afate të reja. Për lehtësimin e funksionimit të subjekteve politike, KQZ-ja ka nxjerr Rregullën 01-2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike¹⁷, e cila specifikon detaje të tjera mbi subjektet politike.

Partia politike e cila është e regjistruar dhe ndodhet në regjistrin e partive politike, nuk ka obligim ta aplikojë, por e njoftoj Zyrën për pjesëmarrjen apo mospjesëmarrjen e saj

11 Neni 11.1 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

12 Neni 12.1 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

13 Neni 12 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

14 Neni 12.6 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

15 Neni 15 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

16 Neni 15.2 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

17 Rregulla 01-2013 <http://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/KQZ-Rregulla-01-2013.pdf>





në zgjedhjet e shpallura. Afati për njoftimin e Zyrës është 15 ditë nga dita kur Presidenti i Republikës e ka deklaruar datën e zgjedhjeve. Zyra po ashtu duhet të njoftohet për çfarëdo ndryshimi nga kryetari i partisë, përfaqësuesit të autorizuar të partisë, përfaqësuesit financiar të partisë si dhe çdo informatë tjetër që është e natyrës së njëjtë. Brenda këtij 15 ditëshi, partia politike duhet ta njoftoj Zyrën se ajo do të marrë pjesë në zgjedhje si pjesë e ndonjë koalicioni.

KQZ-ja sipas rekomandimeve nga Zyra më pas certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrje në zgjedhje vetëm pasi që ai subjekt politik t'i ketë plotësuar kushtet e parapara me ligj dhe rregulla të KQZ-së. Secili aplikim duhet të shoqërohet me materiale përcjellëse. Për certifikim, KQZ-ja përmes rregullës ka mundësi të vendos një shumë të caktuar, pagesa e të cilës më pas e kualifikon partinë politike që t'i shqyrtohet lënda.

Zyra i shqyrton secilin nga aplikimet për certifikim dhe ka në kompetencë që të vlerësojnë nëse subjekti politik ka plotësuar apo nuk i ka plotësuar kërkesat ligjore për t'u certifikuar. Në rast kur subjekti politik nuk i plotëson kushtet për certifikim që janë paraparë me ligj, Zyra brenda 10 ditësh nga dita e aplikimit e informon subjektin politik me arsyen ose arsyet që aplikimi i tyre nuk ka qenë i mjaftueshëm. Aplikuesi ka të drejtë që 5 ditë pune nga dita që pranon informimin ta korrigjojë aplikacionin apo të shpëtojë e adresoj brengat e identifikuar.

5 ditë pasi që Zyra ka pranuar dokumentacionin e plotë ka obligim që të jep rekomandim me shkrim për aplikuesin. Rekomandimi mund të jetë pozitiv apo negativ për aplikuesin dhe secili rekomandim sipas kërkesës ligjore mban një shpjegim të shkurtër për secilin kriter ligjor. KQZ-ja pasi që ka pranuar rekomandimet nga Zyra në afat prej 7 ditësh miraton ose refuzon certifikimin e subjekteve politike. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra ka obligim që menjëherë ta njoftoj subjektin politik në lidhje me vendimin, dhe në rastin kur është negativ, atëherë subjekti ka të drejtë që në afat prej 5 ditësh nga dita e pranimit ta dorëzojë ankesën për mos certifikim në PZAP.

Tek Zyra duhet të regjistrohesh të gjitha koalicionet para zgjedhore, nismat qytetare, kandidatët e pavarur, ku të gjithë duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e vendosura në Ligj.¹⁸

Subjekti politik, koalicioni, ose nisma qytetare kanë për obligim që në ZRPPC ta dorëzojnë edhe listën e kandidatëve për zgjedhje, sipas periudhës kohore që përcaktohet me rregullat e KQZ-së. Në rastet kur subjekti politik, koalicioni apo nisma qytetare ka dështuar të paraqes para Zyrës listën, atëherë KQZ-ja mund ta tërheq vendimin për certifikim. Subjekti politik, nisma qytetare apo koalicioni kanë të drejtë që për vendimin e KQZ-së t'i drejtohen PZAP-së me ankesë, në afat prej 5 ditë pune nga dita pranimit të njoftimit.¹⁹

Listës së kandidatëve, Zyra fillimisht i bënë një shqyrtim nëse është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji e më pas në varësi të listës ia përcjellë një rekomandim me shkrim, pozitiv apo negativ KQZ-së, në afat prej 5 ditësh nga dita kur ka përfunduar dorëzimi i listave. Nëse lista nuk i plotëson kushtet, Zyra së bashku me arsyet i jep një afat prej 5 ditë pune subjektit politik, koalicionit apo nismës qytetare që ta korrigjojë listën. Tutje subjekti politik, nisma qytetare apo koalicioni kanë afat prej 3 ditë pune që ta dorëzojnë listën e korrigjuar me arsyetimin për çështjet e identifikuar nga Zyra.

Mbikëqyrja financiare e shpenzimeve të fushatës

Subjektet politike për realizimin e fushatës zgjedhore dhe funksionimin e përditshëm të tyre duhet të kenë mjete materiale dhe përkrahje nga shteti²⁰, anëtarësia, kandidatët dhe mbështetësit e subjektit politik. Për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi, nga Fondi, ndan mjete me propozim të Qeverisë por jo më shumë se 0.05% të buxhetit të Kosovës. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë i ka lënë mundësi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të përcaktojë rregullën mbi shpenzimet maksimale (tavanet), të cilat subjektet politike mund t'i bëjnë në zgjedhje. Rregulla publikohet 5 ditë pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve.²¹ Maksimumi i shpenzimeve të fushatës mbështetet në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve. Shpenzimet maksimale sipas LZP-së janë të gjitha shpenzimet e fushatës pavarësisht nëse është mall apo shërbim i shpenzuar për fushatë.

¹⁸ Neni 17, 18, 19 dhe 20 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

¹⁹ Neni 26 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

²⁰ Neni 7 Ligji për Financimin e Subjekteve Politike Ligji nr. 03/L-174, i plotësuar dhe ndryshuar nga Ligji 04/L-058 dhe 04/L-212 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 30 i shpallur me datën 23.08.2013 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>

²¹ Neni 39 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>



Ndërsa subjekti politik nuk mund të pranoj çfarëdo kontributi, përveç ashtu siç është e rregulluar me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.

Për çdo shpenzim të realizuar në fushatë, subjekti politik duhet të mbajë evidencë të saktë dhe më pas të përpilojë një raport financiar. Ky raport duhet të përfshijë të gjitha shpenzimet e subjektit politik (të degëve dhe trupave tjera të subjektit). Raporti duhet të përfshijë periudhën prej 45 ditë para zgjedhjeve dhe 45 ditë pas mbarimit të zgjedhjeve. Ditët numërohen si ditë kalendarike.²² Raporti i Deklarimit Financiar të Fushatës së subjektit politik duhet të publikohet në mjetet e informimit të paraparë më së largu gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Përmbajtja e raportit financiar të fushatës së subjekteve politike duhet të ketë këto të dhëna:

- a) Të ardhurat e subjektit politik për periudhën raportuese, përfshi burimin dhe datën e gjitha kontributeve në para të gatshme;
- b) Të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese; dhe
- c) Bilancin mbi pasuritë, detyrimet dhe barazimet e subjektit nga dita e parë deri në ditën e fundit të periudhës së raportimit.²³

Subjektet politike obligohen që të caktojnë zyrtarët për financan, ndërsa Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ka obligim ligjor që këta zyrtar në momentin e emërimit të ju ofrojë një trajnim për llogaritje dhe auditim. Ligji lejon që zyrtarët financiar të subjektit politik t'i shmangen këtij trajnimi nëse ata dëshmojnë se kanë përvojë dhe ekspertizë të mjaftueshme dhe se për ta një trajnim i tillë nuk është i nevojshëm.²⁴

Pasi subjektet politike t'i kenë dorëzuar raportet financiare të fushatës tek KQZ-ja, Zyra (ZRPPC) ka të drejtë të auditojë secilin raport të publikimit financiar të fushatës apo formular të publikimit financiar të kandidatit dhe partisë. Normalisht

që auditimi i deklarimeve (raporteve) financiare të subjekteve politike realizohet nga Auditorët e certifikuar në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë. Këta auditorë përzgjidhen nga Kuvendi i Kosovës përmes procedurave të tenderit publik.²⁵ Raportet e publikuara të fushatës së Subjekteve politike pasi që të publikohen nga KQZ-ja mund të ekzaminohen nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Para ndryshimeve ligjore të vitit 2013, përgjegjëse për shpalljen e tenderit dhe gjetjen e auditorëve ka qenë ZRP-PC-ja, por që me qëllim të krijohet pavarësi më e madhe, me ndryshimet ligjore kompetencat i kanë kaluar Kuvendit të Kosovës, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Nëse subjekti politik dëshon në paraqitjen e raportit financiar të fushatës sipas LZP-së, atëherë KQZ-ja ka të drejtë që ta ngarkojë subjektin politik me pagesa administrative. Kjo, pasi që Zyra ta ketë njoftuar KQZ-në në lidhje me dështimin e subjektit politik. Ligji lejon ankesën e subjektit politik që të paraqes ankesë kundër vendimit të KQZ-së në procedurë administrative brenda gjykatës. Subjekti politik i cili humb betejën ligjore, kurse vendimi i KQZ-së mbetet në fuqi duhet ta bëjë pagesën dhe dëshminë ta paraqes tek Zyra (ZRP-PC).²⁶

ZRPPC-ja sigurohet se raportet financiare të subjekteve politike të jenë transparente për publikun, duke i publikuar ato së bashku me raportet vjetore financiare (në ueb faqen e KQZ-së. Sipas LZP-së, Zyra ka për obligim që ta tregoj në publik edhe regjistrin e donatorëve, kopjet e Raporteve të publikimit financiar të fushatës, kopjet e formularëve të publikimit financiar për kandidatët e certifikuar dhe kopjet e raporteve përfundimtare të kandidatëve të certifikuar lidhur me auditimin.²⁷

Si përfundim subjektet politike janë të lidhura ngushtë me Zyrën (ZRPPC) që nga akti i regjistrimit, certifikimi, si dhe deri te kontrolli e raportimi i vazhdueshëm financiar për të hyrat dhe shpenzimet e tyre.

²² Neni 40 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

²³ Për të gjitha shpenzimet e subjektit politik gjatë periudhës raportuese, subjekti duhet të paraqes dëftesat për secilën pagesë administrative të paguar. Madje të gjitha këto pagesa mbi shumë 100 euro subjekti detyrohet të rruaj deri në 7 vite së bashku me raportin financiar dhe të gjitha detajet tjera përfshi edhe librat e mbajtjes së llogarive, shërbimet bankare për të gjitha llogaritë, dokumentet e pasurisë, pronësisë apo posedimit, kontratat e lidhura për qira apo blerje të pasurive të luajshme apo paluajshme, të gjitha kontributet në subjekt pavarësisht kohën se kur janë bërë. Kontributet e bëra duhet të regjistrohen dhe të mbahen sipas procedurës ligjore. Regjistrimi i kontributit përfshin marrjen e të dhënave personale si emrin e plotë, adresën, numrin e ID ose pasaportës të secilit kontribuues, vlerën e kontributit, datën e secilit kontribut, dhe emrin e personit që e ka pranuar kontributin.

²⁴ Neni 40.7 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

²⁵ Neni 19 Ligji për Financimin e Subjekteve Politike Ligji nr. 03/L-174, i plotësuar dhe ndryshuar nga Ligji 04/L-058 dhe 04/L-212 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 30 i shpallur me datën 23.08.2013 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>

²⁶ Neni 42 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>

²⁷ Neni 43 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji nr. 03/L-073 i qasshëm në Gazetën Zyrtare numër 31 i shpallur me datën 15.06.2008 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>



Problemet në mbikëqyrjen financiare nga Zyra

Marrja e kompetencave ligjore që kishte KQZ-ja në shpalljen e tenderit për auditimin e raporteve financiare të subjekteve politike dhe kalimi i tyre tek Kuvendi i Kosovës ka bërë që caktimi i auditorëve, rrjedhimisht auditimi i raporteve financiare të subjekteve politike të vonohet vazhdimisht.

Nga viti 2014 e deri në vitin 2017, Kuvendi ka dështuar vazhdimisht që përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike t'i përzgjedhë auditorët. Kjo ka bërë që për 4 vite rresht (2013, 2014, 2015 dhe 2016) raportet financiare të subjekteve politike të mos auditohen dhe të mbeten larg syrit të publikut. Arsyet për mos përzgjedhjen e auditorëve nga Kuvendi lidhen me shumën e pamjaftueshme të mjeteve të ndara nga buxheti, respektivisht ofertat e larta të kompanive të auditimit në tender. Pavarësisht këtyre problemeve, buxheti për auditim nuk është rritur asnjëherë.

KDI-ja në janar të vitit 2017 përmes kërkesës për qasje në dokumente publike i kishte kërkuar Zyrës dhe KQZ-së që të ofroj qasje në raportet financiare të pa audituara të subjekteve politike, porse kërkesë ishte refuzuar nga Zyra. KDI-ja kishte dërguar lëndën tek Avokati i Popullit, i cili në janarin e vitit 2018 i kishte dhënë të drejtë KDI-së për qasje në raportet financiare të paaudituar të subjekteve politike. Por, edhe më tutje Zyra nuk ka lejuar qasje, me arsyetimin se ligji e ndalon një veprim të tillë. Pak muaj më vonë Zyra ka publikuar raportet e audituara, kjo pasi që Kuvendi pas 4 vitesh arriti t'i zgjedh auditorët, ndaj u kryen edhe auditimet për katër vjet. Pas zgjedhjes së këtij ngërçi disa vjeçar, Kuvendi nuk i ka përzgjedhur auditorët, ndaj publiku është privuar t'i shohë raportet e audituara të subjekteve politike për vitet 2018-2019, ndonëse të dyja ishin vite zgjedhore (zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme dhe zgjedhjet lokale).²⁸

Raportet financiare të subjekteve politike që janë dorëzuar tek Zyra (ZRPPC) publiku nuk ka arritur t'i shohë as në vitin 2020, me përjashtim të raporteve financiare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të tetorit 2019 kur KQZ-ja përmes Zyrës në dhjetorin e 2019-ës kishte vendosur publikimin e tyre siç janë dorëzuar nga subjektet politike në afatin e paraparë ligjor.²⁹

Në analizimin e raporteve sikurse atyre të audituara ashtu edhe atyre të paaudituar vërehet se deklaratimet financiare të paraqitura nga subjektet politike janë të mangëta. Shumë subjekte politike vazhdojnë të mos paraqesin pasqyrat reale të të hyrave dhe shpenzimeve që kanë realizuar, sidomos në kohë fushate.

Bazuar në deklaratimet financiare të subjekteve politike, ato asnjëherë nuk e tejkalojnë limitin (tavanin) e shpenzimeve të vendosur nga KQZ-ja për shpenzimet gjatë fushatës zgjedhore që është 0.50 euro për votues të regjistruar. Këto shuma bien ndesh me raportet e koalicionit për vëzhgim të zgjedhjeve "Demokracia në Veprim", të marra nga monitorimi direkt i aktiviteteve të fushatës, të cilat tregojnë për tejkalim të shumave të shpenzimeve për dallim nga deklaratimet e subjekteve.³⁰

Megjithatë, Zyra apo KQZ-ja nuk e ka një mekanizëm me të cilin do kishte mundësi që të kontrollonte se sa janë shpenzimet që paraqiten dhe çfarë janë çmimet e tregut në mënyrë që më pas të bëhen krahasimet në mes deklaratimit dhe realitetit. Një mekanizëm i tillë do të rriste kapacitetet brenda Zyrës për kontroll dhe një pavarësim të Zyrës nga KQZ-ja. Por, për krijimin e një mekanizmi të tillë duhen ndryshime ligjore, të cilat varen nga vullneti politik i subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend. Kontrolli dhe vendosja e gjobave për subjektet që i tejkalojnë limitet do

28 Lista e raporteve financiare të audituara: <http://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-vjetore-financiare-te-audituar/> dhe Lista e raporteve financiare të audituara të fushatave zgjedhore <http://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-financiare-te-fushatave-zgjedhore-te-audituar/>

29 Qasja e tyre në ueb faqen e KQZ-së <http://kqz-ks.org/lajmet/kqz-publikon-dosjen-e-informimit-publik-per-subjektet-politike-dhe-kandidatet-e-zgjedhjeve-2019/>

30 Raporti i vëzhgimit të zgjedhjeve 2019 (Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës), dhjetor 2019 Faqe 33, I qasshëm në: https://demokracianeveprim.org/wp-content/uploads/2019/12/DnV_RAPORTI-I-V%C3%8BZHGIMIT-T%C3%8B-ZGJEDHJEVE.pdf



|||||

Në kuadër të ndryshimeve ligjore duhet të parashihen kompetenca të shtuara për Zyrën (ZRPPC) duke i dhënë njëlloj pavarësie brenda KQZ-së me kompetenca të plota administrative të hetimit, auditimit dhe gjatë së parregullsisë që gjenden tek raportet financiare të subjekteve politike. Mëpas, shtimi i stafit mbështetës për Zyrën do ta fuqizonte atë dhe do të shpejtonte veprimet që do të ndërmerreshin ndaj subjekteve politike që do të vepronin kundër normave ligjore.

të ishte një mundësi e mirë për disiplinimin e subjekteve politike.

Për më tepër, Zyra dhe as KQZ-ja nuk merren fare me shpenzimet e kandidatëve për deputetë, kryetarëve apo këshilltarëve të komunave gjatë fushatës, kjo ngase nuk kërkohet me ligj. Pra shpenzimet e kandidatëve nuk regjistrohen dhe nuk raportohen askund. Madje nuk ka as limit se sa mund të shpenzojnë kandidatët gjatë fushatës zgjedhore. Kjo zbrazëti ligjore ka bërë të mundur garë të pabarabartë zgjedhore, duke favorizuar kështu në garë kandidatët më të "fuqishëm" financiarisht dhe prani më të madhe të tyre në publik.

Kjo hapësirë ligjore duhet sa më shpejtë të rregullohet dhe në kuadër të ndryshimeve ligjore që duhet të bëhen në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Ligjin për Financimin e Subjekteve duhet të parashihen norma të cilat i detyrojnë kandidatët të raportojnë për shpenzimet gjatë fushatës. Kjo është kërkuar edhe me Agjendën për Reforma Evropiane (ERA), pika tre e së cilës kërkon sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së fondeve për partitë politike³¹. Për më tepër është kërkuar: 1. Përgatitja e pakos ligjore për reformën zgjedhore, duke përfshirë rekomandimet e misionit vëzhgues të BE-së dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut; 2. Përgatitja e Ligjit për financimin e partive politike dhe kërkesa për opinion nga komisioni i Venedikut dhe 3. Përfundimi i auditimit të financave të partive politike; Publikimi i raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj.³²

Po ashtu, në kuadër të ndryshimeve ligjore duhet të parashihen kompetenca të shtuara për Zyrën (ZRPPC) duke i dhënë njëlloj pavarësie brenda KQZ-së me kompetenca të plota administrative të hetimit, auditimit dhe gjatë së parregullsisë që gjenden tek raportet financiare të subjekteve politike. Mëpas, shtimi i stafit mbështetës për Zyrën do ta fuqizonte atë dhe do të shpejtonte veprimet që do të ndërmerreshin ndaj subjekteve politike që do të vepronin kundër normave ligjore.

31 ERA <https://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf>

32 Për më shumë rreth ERA-së mund të mësoni në: <http://eramonitoring.org/category/qeverisja-e-mire-dhe-sundimi-i-ligjit/>

|||||



Republika Çeke dhe rregullimi ligjor i mbikëqyrjes së financave të subjekteve politike

Zyra për mbikëqyrjen e financimit të partive dhe lëvizjeve politike (*Úřad pro dohled nad hospo- dařením politických stran a politických hnutí*ose „ÚDHPŠH“ apo “Zyra”), ka filluar aktivitetet e saj më 1 janar të vitit 2017 me Ligjin Nr. 302/2016 Coll., i cili ndryshon Ligjin nr. 424/191 coll. për asociimin në parti dhe lëvizje politike, ashtu siç është amandamentuar (AAPP)

Themelimi i zyrës rezultoi nga rekomandimet e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) drejtuar Republikës Çeke në vitin 2011. Rekomandimet në mënyrë të veçantë përfshinin:

- a) Kërkesën për përfshirjen e donacioneve për partitë në raportet e tyre financiare si dhe publikimin e tyre,
- b) Kërkesën për konsolidimin e llogarive të partive dhe,
- c) Kërkesën për krijimin e një zyre të pavarur që mbikëqyr veprimtaritë ekonomike të partive politike dhe sanksionon shkeljet e mundshme.

Republika Çeke ka dështuar që t`i përmbush këto kërkesa, prandaj GRECO ka iniciuar procedurën për mospërmbushje, duke ushtruar presion të fuqishëm për miratimin e legjislacionit për reformimin e ligjit për mbikëqyrje të aktiviteteve ekonomike të partive politike.

Para se zyra të themelohej, raportet financiare të partive dhe lëvizjeve politike³³ duhej të certifikoheshin nga një auditor i pavarur i zgjedhur prej tyre. Pasqyrat vjetore financiare nga viti i kaluar duhej të rishikoheshin nga Komiteti për Kontroll Buxhetor i Dhomës së Deputetëve të Parlamentit³⁴. Por, duke pasur parasysh kapacitetet dhe përbërjen politike të Komitetit, nuk mund të ketë pasur kontroll të paanshëm ose të pavarur.

33 Së bashku të referuar edhe si “parti politike”. Nuk ka asnjë dallim ligjor mes një partie dhe lëvizje politike në sistemin juridik të Çekisë

34 Dhoma e ulët e Parlamentit Çek.



Pozita e Zyrës brenda kornizës së administratës publike dhe përbërja e saj

ÚDHPSH-ja ndodhet në Bërno (qyteti i dytë më i madh në Republikën Çeke), dhe është organ qendror i administratës publike sipas Ligjit mbi Kompetencat. Ai është një institucion i pavarur, që u përgjigjet vetëm ligjeve në fuqi. Ndërhyrja në funksionimin e Zyrës mund të bazohet vetëm në ligj³⁵. Si organ qendror i administratës publike, Zyra ka kategorinë e vet në buxhetin e shtetit të Republikës Çeke.³⁶ Për vitin 2020 buxheti arrin në 34.444.691 CZK (rreth 1,3 milion euro).

Zyra përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe punonjës të tjerë. Kryetari e ka autorizimin që t`i urdhëroj të punësuarit dhe të aprovoj strukturën organizative të Zyrës, orarin e operimit dhe raportin vjetor të aktivitetit. Njëri prej anëtarëve të zgjedhur nga Kryetari vepron në emër të tij në rast të mungesës së kryetarit.

Kryetari zgjidhet ndërmjet dy kandidatëve - një i propozuar nga Dhoma e Deputetëve dhe një nga Senati³⁷. Kryetari emërohet nga Presidenti i Republikës Çeke. Po ashtu, anëtarët e Zyrës emërohen nga Presidenti i Republikës Çeke. Ata zgjidhen nga Senati (dhoma e lartë e Parlamentit):

- a) Një duke u bazuar në propozimin nga Kryetari i Zyrës së Lartë të Auditimit
- b) Dy nga kandidatët e përzgjedhur nga Dhoma e deputetëve, dhe
- c) Një nga kandidatët e sugjeruar nga anëtarët individual të senatit.

Kryetari i ÚDHPSH-së, emërohet për një mandat prej 6 vjetësh dhe nuk mund të emërohet për më shumë se dy herë radhazi. Kushtet e nevojshme për mbajtjen e funksionit të kryetarit janë si në vijim: duhet ta ketë shtetësinë e Republikës Çeke, aftësi të plotë juridike, dosje të pastër penale³⁸, studime të përfunduara të nivelit Master dhe t`i plotësoj kushte shtesë të parapara me Ligjin për Lustrimin³⁹. Për më tepër, Kryetari nuk duhet të ketë pasur asnjë funksion politik brenda tre viteve para emërimit të tij, me përjashtim të funksionit të anëtarit të Asamblesë Komunalet. Po ashtu, i nënshtrohet edhe kërkesës për mospërpunthjen (inkompatibilitetin) e funksioneve⁴⁰, ndaj rrjedhimisht kryetari nuk duhet të mbajë ndonjë pozitë tjetër me pagesë apo të kryej ndonjë aktivitetet fitimprurës, me përjashtim të aktiviteteve standarde edukative dhe publike.

35 ÚDHPSH-ja duhet të ndjekë ligjet, dekretet qeveritare dhe rregulloren e autoriteteve të tjera. Ajo është e detyruar të zbatojë rregullat e çdo ligji, siç është siguria në punë, rregullat e shëndetit publik ose rregullat e administrimit të mbeturinave dhe shumë të tjera. Megjithatë, vet funksionimi i Zyrës nuk duhet të ndikohet nga ndonjë akt tjetër juridik përveçse ligjit. Qeveria dhe autoritetet e tjera nuk kanë të drejtë të vendosin se si Zyra e përbush rolin e saj si autoriteti mbikëqyrës për financimin e partive politike. Ky është dallimi kryesor në krahasim me ministritë, të cilat menaxhohen drejtpërdrejt nga qeveria

36 Prandaj, korniza financiare varet vetëm nga Ligji për Buxhetin e Shtetit, i cili miratohet çdo vit nga Dhoma e Deputetëve për çdo vit kalendarik. Gjatë vitit, nuk është e mundur të përshtatet korniza.

37 Dhoma e lartë e Parlamentit Çek

38 Në kuptimin e AAPP-së: Regjistri penal i një personi është i pastër, kur ata nuk janë gjetur efektivisht fajtorë për një krim të qëllimshëm në çfarëdo rasti ose për një krim neglizhent të lidhur me shërbimin publik

39 Aprovohet për diskualifikim masiv të atyre që lidhen me abuzimet nën Regjionin Komunist të para vitit 1989

40 Kryetari i ÚDHPSH, në të njëjtin kohë, nuk lejohet të jetë kryetar i Republikës Çeke, anëtar i qeverisë, anëtar i Parlamentit, anëtar i Parlamentit Evropian, gjyqtar, prokuror, anëtar i Zyrës së Auditorit në Çeki, anëtar i Këshillit të Bankës Kombëtare të Çekisë dhe nuk lejohet të mbajë ndonjë funksion tjetër në shërbimin publik dhe të jetë anëtar i një partie politike



Kushtet e nevojshme për anëtarët e Zyrës janë të krahasueshme me ato për Kryetarin. Për dalim me funksionin e Kryetarit, anëtarët e zyrës mund të rriemërohen pa kufizime në mandatin e tyre 6-vjeçar. Aktiviteti i mëparshëm politik kufizohet vetëm në mosaktivizimin prej 2 vitesh para emërimit.

Mandati i kryetarit ose anëtarëve të Zyrës *përfundon* në fund të afatit ligjor, ose me dorëheqjen, largimin, shkeljet eventuale ligjore, humbjen e aftësisë juridike ose shtetësisë së shtetit. Presidenti i Republikës Çeke e shkarkon kryetarin ose anëtarin e Zyrës nëse ai/ajo nuk përmëshin kushtet e përcaktuara për shtetësinë, arsimin, sipas Ligjit për Lustracionit, ose nëse ata marrin pozitë që nuk është në pajtueshmëri me funksionin e Kryetarit ose anëtarit të Zyrës.

Numri i përgjithshëm i posteve të përcaktuara administrative në ÚDHPSH, përfshirë kryetarin dhe anëtarët e Zyrës (sipas raportit vjetor të vitit 2018) është 19. Dhjetë prej tyre rregullohen me Ligjin për Shërbimin Civil të Çekisë, nëntë të tjera shërbejnë sipas Kodit të Punës⁴¹. Në bazë të një strukture organizative të Zyrës (miratuar nga Kryetari), punonjësit aktualisht janë të ndarë në dy departamente: Departamenti i Zyrës së Kryetarit dhe Departamenti i Kontrollit dhe Procedurave Administrative.

Numri i përgjithshëm i posteve të përcaktuara administrative në ÚDHPSH, përfshirë kryetarin dhe anëtarët e Zyrës (sipas raportit vjetor të vitit 2018) është 19. Dhjetë prej tyre rregullohen me Ligjin për Shërbimin Civil të Çekisë, nëntë të tjera shërbejnë sipas Kodit të Punës. Në bazë të një strukture organizative të Zyrës (miratuar nga Kryetari), punonjësit aktualisht janë të ndarë në dy departamente: Departamenti i Zyrës së Kryetarit dhe Departamenti i Kontrollit dhe Procedurave Administrative.

41 Ligji Nr. 234/2015 Col., për Shërbimin Civil, i ndryshuar, profesionalizon shërbimin civil dhe siguron zyrtarisht pavarësinë më të fortë të zyrtarëve. Marrëdhëniet standarde të së drejtës së punës përfshijnë kryetarin dhe pesë anëtarë të Zyrës, të cilët emërohen dhe pushohen nga procedurat speciale të dhëna nga AAPP





Mbikëqyrja e financimit të partive politike nga ana e Zyrës

Qëllimi kryesor i zyrës është të realizoj mbikëqyrjen mbi financimin e partive, lëvizjeve dhe instituteve politike⁴². Zyra e bën mbikëqyrjen duke ekzaminuar raportet vjetore financiare të partive politike dhe duke realizuar kontrollet e saj⁴³. Mbikëqyrja realizohet nga kryetari, anëtarët si dhe nga punonjësit e autorizuar.

Çdo vit deri më 1 prill, të gjitha partitë politike duhet t'i ofrojnë zyrës *raportin vjetor financiar*. Raporti përmban: pasqyra financiare, raporte të auditimit, deklarata të fitimit sipas zërave buxhetor (përfshirë aksionet në korporata, kredit, huat dhe borxhet e tjera), shpenzimet për paga, shpenzimet e përgjithshme, shpenzimet individuale të zgjedhjeve, të gjitha dhuratat e marra, donacionet dhe performancat e tjera jofinanciare, asetet e trashëguara, listën e anëtarëve pagesat e anëtarësisë të së cilëve kalon 50.000 CZK dhe informatat në lidhje me institutet politike, nëse janë të krijuara. Raporti vjetor financiar është **publik**. Zyra i publikon këto raporte vjetore financiare, së bashku me gjetjet e kontrollit të tyre. Zyra e informon Ministrinë e Financave në lidhje me realizimin e detyrave të saj për publikimin e raporteve dhe rezultatet e vlerësimit.

Raporti vjetor financiar është publik. Zyra i publikon këto raporte vjetore financiare, së bashku me gjetjet e kontrollit të tyre. Zyra e informon Ministrinë e Financave në lidhje me realizimin e detyrave të saj për publikimin e raporteve dhe rezultatet e vlerësimit.

42 Subjektet juridike të themeluar nga partitë politike u përqendruan në hulumtime, arsim dhe/ose publikim

43 Për më tepër, ÚDHPSH-ja ka të drejtë të ndëshkojë për vepra penale dhe publikon një raport vjetor. AAPP-ja i mundëson ÚDHPSH-së të kryejë çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj





Mbikëqyrja mbi fushatat zgjedhore nga ana e zyrës

Përveç mbikëqyrjes së veprimtarive ekonomike të partive dhe lëvizjeve politike, zyra e mbikëqyrë dhe kontrollon financimin e fushatave zgjedhore individuale para çdo zgjedhjeje.

Më e rëndësishmja është përkufizimi i fushatës zgjedhore. Kësisoj “fushatë zgjedhore”, cilësohet çdo reklamim ose kërkim i votave për një kandidat, duke përfshirë deklaratat publike të mbështetjes, si dhe deklaratat kundër kundërshtarëve, të paraqitura në periudhën e shpallur para ditës së zgjedhjeve.

Autoriteti mbi fushatat zgjedhore i është dhënë Zyrës me Aktin Nr. 322/216 Coll., që amandamenton ligjin për zgjedhjet dhe aktet e tjera të ndërlidhura, që hyri në fuqi edhe më 1 Janar 2017.⁴⁴ Prandaj, zyra e bënë mbikëqyrjen e financimit të fushatave zgjedhore për Dhomën e Deputetëve⁴⁵, Senatin⁴⁶, asamblatë rajonale⁴⁷, Parlamentin Evropian⁴⁸ dhe për president⁴⁹.

Në mesin e detyrimeve themelore të secilës parti politike dhe secilit kandidat individual janë:

- a) hapja dhe mirëmbajtja e një *llogarie bankare zgjedhore transparente*,
- b) Mirëmbajtja e librave financiare dhe
- c) Publikimi i një raporti mbi financimin e fushatës zgjedhore brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të përgjithshme të zgjedhjeve.

Ekzistojnë kufij financiar për shpenzimet për çdo zgjedhje nën mbikëqyrjen e Zyrës. Kufijtë përcaktohen ndryshe për secilën fushatë zgjedhore përmes një akti juridik përkatës, sipas llojit të zgjedhjeve (shiko fusnotat më poshtë; shumica gjithmonë përfshin TVSH-në).

Personi fizik ose juridik që synon të marrë pjesë në një fushatë zgjedhore pa dijeninë e kandidatit duhet të regjistrohet nga ÚDHPSH-ja para se t'i bashkohet fushatës (në terma ligjor: “personi i tretë i regjistruar”, shkurtuar si PTR).

44 Rregullat për fushatat zgjedhore përfshihen në secilin akt ligjor për zgjedhjet. Rregullat janë përgjithësisht të unifikuara. Ndarja e tyre në akteve të ndryshme juridike buron nga teknika legjislative Çeke, pasi rregullat për secilën zgjedhje përcaktohen në ligjin përkatës

45 § 16 – 16i të Ligjit Nr. 247/1995 Coll., mbi Zgjedhjet për Parlamentin e Republikës Çeke, i ndryshuar, kufiri financiar i ndryshuar për partinë politike: 90 milion CZK kufizimi financiar për PTR: 1,8 milion CZK

46 të njëjtat dispozita të ligjit si për Dhomën e Deputetëve kufiri financiar për partinë/kandidatin politik: 2 milion CZK për kandidat (2,5 milion CZK, nëse merr pjesë në raundin e dytë) kufiri financiar për PTR: 40.000 CZK për secilën zgjedhje (50.000 CZK nëse zhvillohet raundi i dytë)

47 § 56a – 56g të Ligjit Nr. 130/2000 Coll., mbi zgjedhjet për Asamblatë Rajonale, i ndryshuar, si kufi financiar për partinë politike: 7 milion CZK shumëzuar me numrin e rajoneve, në të cilat ata kandidojnë kufiri financiar për PTR: 140.000 CZK shumëzuar me numrin e rajoneve ku ata bëjnë fushatë

48 § 59 – 59f të Ligjit Nr. 62/2003 Coll. mbi Zgjedhjet për Parlamentin Evropian, i ndryshuar, kufiri financiar për partinë politike: 50 milion CZK, limit financiar për PTR: 1 milion CZK

49 § 35 – 38b të Ligjit Nr. 275/2012 Coll., mbi Zgjedhjet për President, i ndryshuar, ku limiti financiar për kandidat: 40 milion CZK (50 milion CZK, nëse merr pjesë në raundin e dytë), limiti financiar për PTR: 800.000 CZK (1 milion CZK nëse zhvillohet raundi i dytë)




Janë përcaktuar kufijtë financiar edhe për personat e tretë të regjistruar.

Zyra mbikëqyr të gjitha fushatat zgjedhore në Republikën e Çekisë përveç zgjedhjeve komunale. Sipas memorandumit shpjegues të Ligjit Nr. 322/2016 Coll., arsyeja e përjashtimit të mbikëqyrjes mbi zgjedhjet komunale është:

- i barrë e tepërt për kandidatët e pavarur dhe asociacionet e tyre,
- ii efekti dekurajues i publikimit të informatave të detajuara për kandidatët (meqenëse në shumë komuna ka probleme me mungesë të interesimit për postet e zgjedhura; atëherë mungon edhe konkurrenca politike) dhe
- iii aktualisht ka nivel të mjaftueshëm të mbikëqyrjes autonome dhe transparencës në fushatat elektorale lokale.

Gjatë miratimit të ligjit, ishte shqyrtuar edhe mbikëqyrja të paktën në fushatat për zgjedhje komunale në qytetet e mëdha apo në Pragë. Por mbizotëroi argumenti që asociacionet e kandidatëve të pavarur nuk kanë kapacitete ligjore dhe rrjedhimisht nuk mund të mbajnë librat dhe nuk mund të bëhen efektivisht përgjegjës për shkeljen e ligjit. Meqenëse këto asociacione kanë të drejtën qytetare që të bëjnë fushata dhe kërkojnë të votohen, rregullorja përgjithësisht kishte qëllimin që të mos u hiqet e drejta për të organizuar fushatën zgjedhore për zgjedhje komunale. Vlen të përmendet se në nivel të komunave të vogla, kandidatët e pavarur janë shpesh përfaqësues të rëndësishëm të interesit publik dhe në disa raste partitë kanë problem të vendosin kandidatët e tyre në nivel të komunave të vogla në Republikën Çeke.

Rregullat e miratuara mund të anashkalohen duke transferuar shpenzimet e fushatës nga një qark individual komunal tek tjetri. Sidoqoftë, zgjedhjet komunale në Pragës të 2018 vunë në pah se mungesa e kufijve për financimin e fushatave të tilla në zgjedhje lokale shkakton probleme. Lëvizja më e fuqishme politike "ANO" investoi 140.200.000 CZK në zgjedhje. Madje kjo tejkalon limitin për zgjedhjet e përgjithshme në Dhomën e Deputetëve që arrin 90.000.000 CZK.





Kompetencat e tjera të Zyrës

ÚDHPSH-ja ka të drejtë të sanksionojë shkeljet e AAPP-së. Në rastet më të rënda, shkelja e detyrimeve dënohet me gjobë deri në 2.000.000CZK, - Gjobat mund të shqiptohen ndaj partive politike, lëvizjeve dhe instituteve politike, si dhe personave fizikë ose juridikë, nëse ato p.sh. nuk përmendin qëllimin e transaksionit të pagesës në fletëpagesë në rastet e ofrimit të mjeteve financiare në llogarinë e partisë.

Sipas propozimit aktual të Aktit për Lobimin, i miratuar nga ana e qeverisë në vitin 2019 dhe i kaluar për diskutim në Dhomën e Deputetëve, Zyra gjithashtu duhet të mbikëqyrë *agjendën e re për lobimin*. ÚDHPSH-ja duhet të menaxhojë regjistrin e lobistëve dhe të mbikëqyrë përmbushjen e detyrave të dala nga ligji. Shkelja e ligjit (mos shpallja e lobimit ose mos dorëzimi i raportit në regjistër) duhet të gjobitet. Megjithatë, propozimi do të debatohet dhe diskutohet gjerësisht nga ligjvënësit (nga viti 2020).

ÚDHPSH-ja duhet të menaxhojë regjistrin e lobistëve dhe të mbikëqyrë përmbushjen e detyrave të dala nga ligji. Shkelja e ligjit (mos shpallja e lobimit ose mos dorëzimi i raportit në regjistër) duhet të gjobitet. Megjithatë, propozimi do të debatohet dhe diskutohet gjerësisht nga ligjvënësit (nga viti 2020).



Funksionimi aktual i Zyrës deri më sot

ÚDHPSH-ja jep informacione lidhur me funksionimin e tij në raportet e veta vjetore.⁵⁰ Që nga data e themelimit të tij, Z. Vojtěch Weis u emërua si Kryetar i Zyrës. Të katër anëtarët e tjerë të Zyrës u emëruan brenda muajve të ardhshëm. Në vitin 2017 - që paraqet vitin e parë të funksionimit - Zyra mori formën e brendshme me ç'rast u hapën konkurse dhe vendet e lira u plotësuan. Aktiviteti kryesor ishte përgatitja e metodologjive të mbikëqyrjes dhe informimit të partive politike lidhur me detyrat e tyre të reja. Procedimet e para filluan në vjeshtën e vitit 2017, për shkak të dhjetëra shkeljeve (dështimi për të hapur, mirëmbajtur ose dhënë informacion mbi llogaritë bankare që detyrimisht duhet të jenë transparente).

Zgjedhjet e përgjithshme të Dhomës së Deputetëve u mbajtën në muajin tetor të vitit 2017. ÚDHPSH-ja kontrolloi llogaritë bankare zgjedhore, materialet zgjedhore dhe donatorët. U iniciuan dhjetëra procedura për shkelje. Procedurat e para për shkeljet në lidhje me raportin për financimin e fushatës së përgjithshme parlamentare filluan në vitin 2018.

Në fund të vitit 2017, Zyra filloi ta kontrollojë fushatën presidenciale. Zgjedhjet presidenciale u zhvilluan më pas në muajin janar të vitit 2018.

Raportet e para vjetore financiare të partive politike për 2017 u vlerësuan (natyrisht) në vitin vijues. Në atë kohë ekzistonin 235 parti politike. ÚDHPSH-ja mori në afatin e duhur kohor 84 raporte të kompletuara dhe 12 jo të kompletuara, si dhe 21 raporte të plota me vonesë. Pjesa tjetër e 18 partive të tjera u njoftuan lidhur me detyrimin e tyre, me ç'rast 67 prej partive dorëzuan raportin. ÚDHPSH-ja gjombiti dhjetëra parti politike dhe në 17 raste propozoi shpërbërjen e partive. Zyra e Qeverisë ka të drejtë të bëjë kërkesë në Gjykatën Administrative Supreme.

Në vitin 2018, Zyra shqiptoi 380 gjoba në shumën totale prej CZK 2.388.200. Gjithashtu është bërë edhe vlerësimi i raporteve që kanë të bëjnë me fushatën e zgjedhjeve të vitit 2017 për Dhomën e Deputetëve.

Zgjedhjet e rregullta për një të tretën e Senatit u zhvilluan së bashku me zgjedhjet komunale (të cilat nuk hyjnë në fushën e ÚDHPSH) në vjeshtën e vitit 2018. Një e treta e partive politike nuk paraqiti raportin vjetor financiar për vitin 2018. Rrjedhimisht, Zyra shqiptoi mbi njëqind gjoba në shumën totale prej CZK 1.596.000 në lidhje me këtë. Gjobat më të larta arritën në CZK 35.000.

Por, kontrollet e para komplekse të shpenzimeve për fushatën zgjedhore në Dhomën e Deputetëve nga viti 2017 filluan në muajin mars të vitit 2019. Zyra zgjodhi të rishikojë 4 nga 9 partitë e suksesshme (ČSSD, ODS, SPD dhe ANO) dhe 2 të pasuksesshme (Realisté dhe SPO) bazuar në dyshimet për disproporcione midis shpenzimeve të treguara dhe atyre reale të fushatës. Partia populiste SPD-ja u gjobit me CZK 250.000, gjë që paraqet deri më tani gjobën më të lartë të shqiptuar nga ana e ÚDHPSH-së. Sipas mediave, partitë e tjera mund të gjobiten gjithashtu, por aktgjykimet përfundimtare nuk janë nxjerrë akoma.

Në fillim të vitit 2020, mediat raportuan për kontrollin kompleks të zgjedhjeve presidenciale, të cilat u mbajtën në muajin janar të vitit 2018. Por, rezultatet e ende nuk janë publikuar.



Problemet e zbuluara në strukturën e ÚDHPSH-së

Pavarësia ligjore e Zyrës është e nivelit të lartë, duke pasur parasysh që klasifikohet si organ qendror i administratës publike. Procesi i emërimit të kryetarit dhe anëtarëve është shpërndarë në disa organe kushtetuese (përkatësisht dy dhomat e Parlamentit dhe Presidenti i Republikës). Kryetari i Zyrës ose anëtarët mund të (dhe duhet të) shkarkohet nga ana e Presidentit i Republikës Çeke vetëm në rrethana të përcaktuara në mënyrë objektive. Formulimi i aktit të AAPP-së ofron interpretim që Presidenti i Republikës Çeke mund ta shkarkojë Kryetarin e Zyrës bazuar në konsideratën e tij. Ky interpretim nuk duhet të mbizotërojë, por ka pasur disa përpjekje për interpretim të tillë të kompetencës presidenciale në praktikën e fundit juridike çeke. Formulimi jo i qëndrueshëm i AAPP-së mund të keqpërdoret gjithashtu.

Funksionimi i ÚDHPSH-së është problematik për shkak të bazave të paqarta ligjore dhe strukturës së paqartë të menaxhimit. Ligji nuk është i qartë sa duhet në lidhje me çështjen e autorizimeve të menaxhimit të anëtarëve të Zyrës. Sipas AAPP-së, vetëm kryetari ka të drejtë të japë urdhra për punonjësit. Struktura e aprovuar organizative gjithashtu thotë se punonjësit janë vartës të kryetarit, por jo të anëtarëve. Kështu që çështja kryesore është shtrirja e autoriteteve të anëtarëve dhe si duhet të menaxhojnë veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe kontrollit, kur ata nuk kanë asnjë pushtet mbi punonjësit pa bashkëpunimin e kryetarit. Deri në vitin 2020 nuk ka pasur një zgjidhje të kënaqshme të kësaj çështje.

ÚDHPSH-ja është zyrë mjaft e vogël në krahasim me ministritë dhe organet e tjera qendrore të administratës publike. Zyra thekson në raportin e saj vjetor për vitin 2018 se numri i ulët i posteve të përcaktuara (punonjësit dhe anëtarët), do të thotë se shumica e tyre grumbullojnë në shumë agjenda, gjë që sjell kërkesa më të larta për ekspertizën e burimeve njerëzore të Zyrës.

Kryetari dhe të gjithë anëtarët e ÚDHPSH-së janë emëruar në fillim të vitit 2017. Afati i të gjitha këtyre mandateve të funksionarëve është 6 vjet dhe të gjithë mbarojnë në 2 muajt e parë të vitit 2023, i cili është afati i rregullt për zgjedhjet presidenciale. Ky fakt rrezikon pavarësinë e Zyrës, sepse e gjithë udhëheqja e saj mund të zëvendësohet në (vetëm) një moment të rëndësishëm.⁵¹

51 Dispozitat e përkohshme të Ligjit Nr. 302/2016 Coll., nuk e trajtojnë këtë çështje. Funksioni i anëtarëve mund të ketë filluar gradualisht apo mandati i disa anëtarëve mund të jetë shkurtuar, ashtu që funksionarët të ndërrohen në mënyrë të vazhdueshme



Problemet e zbuluara në operimin e ÚDHPSH-së

Nga themelimi i Zyrës e deri më sot duket qartë se raportet e partive për financimin e fushatave zgjedhore kanë cilësi të dobët dhe janë shumë të paqarta, gjë që ndërlikon funksionin e kontrollit të Zyrës. Sidoqoftë, ÚDHPSH-ja ka mjete për të vlerësuar çmimet e tregut sa i përket shërbimeve të ofruara, kështu që mund të krahasojë shifrat e dhëna me gjetjet e veta të vlerësuar.

Komplikimet në kontrollin e fushatave zgjedhore janë shkaktuar edhe nga fakti se zgjedhjet e Senatit (Dhoma e Epërme e Parlamentit) zhvillohen gjithmonë në përputhje me zgjedhjet e tjera. Pastaj duhet dalluar se cilave zgjedhje u përkasin shpenzimet (për të kontrolluar limitet).

Mbi të gjitha, nuk ka as limite financiare për fushatat komunale dhe as autoritetin e ÚDHPSH-së për të mbikëqyrë këto fushata, të cilat mund të keqpërdoren nga partitë politike duke transferuar efektisht shpenzimet e bëra gjatë fushatës së Senatit në ato të zgjedhjeve komunale, të cilat nuk mund të kontrollohen nga asnjë autoritet.

Nga praktika shohim se Zyra ka vonesa të mëdha në ndëshkimin e shkeljeve themelore gjatë fushatave zgjedhore. Kontrolli i detajuar i shpenzimeve për fushatën zgjedhore në Dhomën e Deputetëve është iniciuar një vit e gjysmë më vonë dhe vonesa në kontrollin e fushatës për zgjedhjet presidenciale ishte edhe më e gjatë (ende nuk ka mbaruar në vitin 2020). Ndikimi i vendimit të tillë të vonuar është i ulët, sepse partitë politike kanë garuar në zgjedhje të tjera ndërkohë dhe kështu kandidatëve që kishin shkelur ligjin disa vite më parë nuk u është dëmtuar reputacioni.

Nga praktika shohim se Zyra ka vonesa të mëdha në ndëshkimin e shkeljeve themelore gjatë fushatave zgjedhore. Kontrolli i detajuar i shpenzimeve për fushatën zgjedhore në Dhomën e Deputetëve është iniciuar një vit e gjysmë më vonë dhe vonesa në kontrollin e fushatës për zgjedhjet presidenciale ishte edhe më e gjatë (ende nuk ka mbaruar në vitin 2020). Ndikimi i vendimit të tillë të vonuar është i ulët, sepse partitë politike kanë garuar në zgjedhje të tjera ndërkohë dhe kështu kandidatëve që kishin shkelur ligjin disa vite më parë nuk u është dëmtuar reputacioni.

Gjobat e shqiptuara deri më tani janë gjithashtu mjaft të ulëta në krahasim me limitet financiare të fushatës dhe shpenzimet reale. Ato targetojnë vetëm shkeljet e detyrës zyrtare. Me gjithë faktin se rezultatet përfundimtare të mbikëqyrjes së fushatave zgjedhore presidenciale nuk janë publikuar ende, gjetjet e ÚDHPSH-së janë relativizuar nga kandidatët e akuzuar.

Me përkrahjen financiare të:

TRANSITION